

VENDIM
Nr. 391, datë 9.6.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR SISTEMIMIN E
HAPËSIRAVE PUBLIKE BREnda ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË FSHATIN
VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN SI NJËSI ZBATUESE TË BASHKISË
KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 157 532 742 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për sistemimin e hapësirave publike brenda zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 31 506 548 (tridhjetë e një milionë e pesëqind e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama